



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.641, datë 23.12.2020

MBI

**PROPOZIMIN PËR LLOJET DHE MASAT E TARIFAVE GJYQËSORE DHE
PROCEDURËN E MBLEDHJES SË TYRE**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 8 të nenit 5, pikën 3 të nenit 7, pikën 3 të nenit 8, pikën 1 të nenit 10 i Ligjit nr. 98/2017 “Për tarifat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, pika 2/ë të nenit 61 i Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikën 2/d të nenit 44 i Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, Ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” dhe Ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

I. Llojet dhe masat e tarifave gjyqësore

1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme

- 1.1. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme, për paraqitjen e kërkesëpadisë, është jo më e ulët se 1 000 (një mijë) lekë dhe jo më e lartë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë.
- 1.2. Masa e tarifave gjyqësore të përgjithshme për gjykimet në gjykatat e apelit dhe Gjykatën e Lartë është jo më e ulët se 2 000 (dy mijë) lekë dhe jo më e lartë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.
- 1.3. Në rastet kur Gjykata e Apelit, ka juridiksionin fillestar, tarifa do të jetë e njëjtë me atë që aplikohet për gjykimin në shkallë të parë.
- 1.4. Palët ndërgjyqëse mund të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore ose shpenzimet e tjera gjyqësore kur është bërë kërkesë prej tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
- 1.5. Çdo organ publik që kryen funksione administrative, gjykatat dhe prokuroria, përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifë gjyqësore, përveç rasteve kur ligji procedural parashikon ndryshe.
- 1.6. Avokatura e Shtetit, përjashtohet si nga pagesa e tarifave dhe nga ajo e shpenzimeve gjyqësore.

- 1.7. Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, sipas neneve 11 ose 12, të Ligjit nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit “Për tarifatat gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”.

TARIFA TË PËRGJITHSHME					
Nr.	Shërbimi gjyqësor	Padi me vlerë deri në 150.000 lekë	Padi me vlerë 150.001 – 5 milion lekë	Padi me vlerë mbi 5,000,001 lekë	Tarifa fikse
1	Kërkesë Padisë Civile / Administrative me vlerë të përcaktuar	1,500 lekë	1 % e vlerës së padisë	1 % e vlerës së padisë	
2	Kërkesë Padisë/kërkesat Administrative me vlerë të papërcaktuar				1,500 lekë
	<p>Shfuqizimin tërësisht apo pjesërisht të aktit administrativ;</p> <p>Ndryshimin, pjesërisht apo tërësisht, të aktit administrativ apo detyrimin e organit publik për të ndryshuar një akt administrativ;</p> <p>Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ;</p> <p>Detyrim të organit publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë;</p> <p>Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;</p> <p>Saktësimin e të drejtave dhe të detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik;</p> <p>Detyrimin e organit publik për të kryer apo për të ndaluar kryerjen e një veprimi tjetër administrativ, të nevojshëm për mbrojtjen e të</p>				

<p>drejtave apo të interesave të paditësit; Përcaktimin e organit që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke urdhëruar kur është rasti dhe shfuqizimin e aktit të nxjerrë nga organi jo kompetent Kërkesa të tjera administrative</p>				
<p>Kërkesë Padisë/kërkesat Civile me vlerë të papërcaktuar Vërtetim fakti. Vërtetësi / pavërtetësi dokumenti. Korrigjim akti të gjendjes civile. Shpallje i zhdukur ose i vdekur. Kërkesa për faliment. Emërim përfaqësuesi ligjor. Veçim pjese takuese Kundërshtim / ankim veprimeve përmbartimore. Pranimi i kërkesave ndreqje gabimi, plotësim vendimi, interpretim etj. Kërkesa të tjera civile</p>			<p>1,500 lekë</p>	
3	<p>Kërkesë Padisë / kërkesat sipas Kodit të Familjes (përfshihen nga pagesa e kësaj tarife gjyqësore të gjitha kategoritë e vendime me objekt të përcaktuar në seksionin 20 të tabelës për tarifën e përgjithshme)</p>	<p>1,500 lekë</p>		
4	<p>Kërkesë Padisë me objekt marrëdhënie pune.</p>	<p>1,000 lekë</p>		
5	<p>Regjistrimi i kërkesave, depozitimeve etj. të OJF-ve, Partive Politike, Sindikatave.</p>	<p>2,000 lekë</p>		
6	<p>Pranimi i kërkesave për lëshim urdhër ekzekutimi për titujt ekzekutiv</p>	<p>1,000 lekë</p>	<p>0,5 % /jo më pak se 1,000 lekë</p>	<p>0,5 % / jo më pak se 1,000 lekë</p>
7	<p>Ndërhyrje kryesore e një pale të re</p>	<p>1,500 lekë</p>	<p>1 % e vlerës së padisë</p>	<p>1 % e vlerës së padisë 1,500 lekë për paditë pa vlerë të përcaktuar</p>
8	<p>Pranimi i ankimeve</p>	<p>2,000 lekë</p>	<p>0.5% por jo më pak se 2,000 lekë</p>	<p>0.2 % por jo më pak se 2,000 lekë 2,000 lekë për paditë pa vlerë të përcaktuar</p>

9	Pranimi i kundër ankimeve				2,000 lekë
10	Pranimi i rekurseve	3,000 lekë	0.5% por jo më pak se 3,000 lekë	0.3 % por jo më pak se 3,000 lekë	3,000 lekë për paditë pa vlerë të përcaktuar
11	Pranimi i kundër rekursit				3,000 lekë
12	Sigurimi i padisë Ndryshim dhe zëvendësim të sigurimit të padisë				1,000 lekë
13	Rivendosje në afat				1,000 lekë
14	Ankim i veçantë				1,500 lekë
15	Rishikim vendimi				2,000 lekë
16	Kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm				2,000 lekë
17	Kërkesë për pezullim ekzekutim vendimi				2,500 lekë
18	Kërkesë për revokimin/ ndryshimin e vendimit të pezullimit të ekzekutimit të vendimit				2,500 lekë
19	Njohja e vendimeve të gjykatave të huaja dhe deklarimi i ekzekutueshmërisë së një vendimi gjyqësor të huaj (përjashtohen nga pagesa e kësaj tarife gjyqësore të gjitha kategoritë e vendime me objekt të përcaktuar në seksionin 20 të tabelës për tarifën e përgjithshme)				5,000 lekë
20	Padi detyrim për ushqim Caktim kujdestari. Kërkesë për birësim. Deklarim braktisje dhe caktim kujdestari. Ndryshim vendimi për përgjegjësitë prindërore. Njohje/kundërshtim atësie dhe amësie Heqja e përgjegjësisë prindërore. Heqje zotësisë për të vepruar Lëshim autorizimi për tjetërsim pasurie. Lëshim autorizimi për dalë jashtë shtetit. Vendosje në përkudësje alternative. Shtrim i detyruar në spital psikiatrik. Urdhra mbrojtje dhe çdo çështje që ka lidhje me to.				200 lekë

Kërkesë për marrjen e masave të përkohshme
 Kërkesë për rregullimin e marrëdhënies së fëmijës me gjyshërit
 Padia për vërtetimin e faktit juridik të lindjes së fëmijës
 Vërtetim fakti që lidhen me të drejtën për pension pleqërie/invaliditeti etj.

2. Tarifa gjyqësore e veçantë

2.1 Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale dhe/ose për shërbime të administratës gjyqësore. Ajo zbatohet gjatë zhvillimit të gjykimit në të gjitha shkallët dhe juridiksionet gjyqësore.

2.2 Tarifa gjyqësore e veçantë e aplikuar është jo më pak se 50 (pesëdhjetë) lekë dhe jo më e shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë.

Tarifa Gjyqësore të Veçanta		
	Shërbimi gjyqësor	Tarifa
Shkalla e parë		
1	Kërkesa për përjashtim gjyqtari/trupi gjykues në shkallët e para të gjykimit	1500 lekë
2	Kërkesa për përjashtim gjyqtari/trupi gjykues Gjykata e Apelit/Gjykata e Lartë	2,500 lekë
Për shërbime të administratës gjyqësore		
3	Kopjo vendimi	600 lekë
4	Fotokopje të dokumenteve.	200 lekë deri në 5 faqe 10 lekë/faqja mbi 5 faqe por jo më pak se 200 lekë
5	Lëshim vërtetimi	200 lekë
6	Kopje audio me CD të seancave gjyqësore.	200 lekë/CD
7	Kërkesa për akses në dokumentet e gjykatës (studim dosje)	300 lekë
8	Shpenzimet e postës, për brenda Shqipërisë (kjo duhet të specifikohet sipas marrëdhënies me vete posten me marrëveshje/kontrate të posaçme)	100 lekë
9	Shpenzimet e postës, për jashtë Shqipërisë	1,000 lekë
10	Transkripte të 1 seancë	500 lekë
	Transkripte të procesit gjyqësor	2,500 lekë

3. Tarifa gjyqësore shtesë

3.1. Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ligjor ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes. (në rastet kur, por pa u kufizuar, palët ndërgjyqëse nuk përmbushin detyrimet procedurale në afatet e

caktuara nga gjykata ose paraqitet kërkesa abuzive të cilat shkaktojnë shtyrje pa shkaqe të arsyeshme të gjykimit)

3.2. Tarifa gjyqësore shtesë vendosen sipas diskrecionit të gjykatës, e cila përcakton mbi shkallën e neglizhencës së palës.

Tarifa gjyqësore shtesë		Tarifa
1	Vonesa në gjykimin e çështjes, shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme në gjykatat e shkallëve të para të gjykimit.	5,000 lekë
2	Vonesa në gjykimin e çështjes, shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme në Gjykatat e Apelit.	10,000 lekë
3	Vonesa në gjykimin e çështjes, shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme në Gjykatën e Lartë.	15,000 lekë

4. Mënyra si mbliidhen dhe paguhen tarifat gjyqësore

- 4.1. Tarifa gjyqësore e përgjithshme paguhet në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, përveçse kur ligji parashikon ndryshe.
- 4.2. Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesë padisë përlllogarit mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative.
- 4.3. Tarifat, të cilat nuk e tejkalojnë shumën prej 2,000 (dymijë) lekë, mund të paguhen me cash në arkën e gjykatës, sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- 4.4. Të ardhurat nga tarifat e paguara në cash në gjykata, duhet të dorëzohen në llogarinë bankare të gjykatës, sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- 4.5. Tarifat, të cilat e tejkalojnë shumën prej 2,000 (dymijë) lekë, paguhen në llogarinë bankare të gjykatës, në një nga bankat e nivelit të dytë, sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- 4.6. Tarifa e paguar nuk kthehet kur hiqet dorë nga kryerja e veprimeve gjyqësore ose kur kërkesë padia kthehet, për shkaqe të tjera që nuk lidhen me pagesën e taksës gjyqësore.
- 4.7. Palët, pas pagesës së tarifës, depozitojnë në kryesekretarinë e gjykatës mandat pagesën bankare.
- 4.8. Çdo gjykatë dorëzon çdo muaj raporte periodike për të ardhurat në Këshillit e Lartë Gjyqësor.
- 4.9. Të ardhurat nga tarifat gjyqësore përdoren sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor
- 4.10. Në momentin e paraqitjes së padisë, të ankimit, të ankimit të veçantë ose të rekursit në gjykatë, kryesekretarja apo personi përgjegjës i jep palës së interesuar faturën për arkëtimin e tarifës, me numrin e llogarisë bankare të gjykatës ku duhet të paguhet tarifa, duke përcaktuar shumën në lekë të saj sipas udhëzimit, si dhe shpenzimet e nevojshme për njoftimet ose shërbimet e tjera gjyqësore për shërbime të administratës gjyqësore.
- 4.11. Sekretarja/personi përgjegjës regjistron në sistemin elektronik financiar të gjykatës veprimin financiar për pagesat e tarifave gjyqësore, sipas udhëzimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

- 4.12. Vlera e padisë llogaritet në momentin e paraqitjes së saj në gjykatë. Kur në kohën e ngritjes së padisë, paraqitet i vështirë caktimi i vlerës së saj, tarifata caktohet nga gjykata në mënyrë të përafërt. Në rast se vlera e padisë rezulton të jetë më e madhe ose më e vogël nga ajo e caktuara nga gjykata, palës së interesuar i kërkohet pagimi i tarifës plotësuese ose i rimbursohet pagesa e tepërt.
- 4.13. Pala paguan shtesën e tarifës, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e urdhërit të dhënë nga gjyqtari
- 4.14. Pagesa e tepërt e tarifës së paguar i kthehet palës paguese:
 - a) plotësisht nga gjykata ose
 - b) nga gjykata ku është kryer pagesa në masën 10% dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore në masën 90%
 - c) Në rastin kur pagesa e tepërt e tarifës kryhet plotësisht nga Gjykata 90 % e shumës së paguar i zbritet kësaj të fundit nga Drejtoria Rajonale Tatimore, në detyrimin për muajin pasardhës.
- 4.15. Pagesa e tepërt kthehet/ rimbursohet vetëm kur vendimi ka marrë formë të prerë.
- 4.16. Kur objekti i padisë pakësohet, tarifa gjyqësore e paguar për kërkesëpadinë e depozituar nuk kthehet. Kur objekti i padisë shtohet, caktohet tarifë shtesë për pjesën e shtuar.
- 4.17. Tarifa gjyqësore shtesë paguhet brenda 21 ditëve kalendarike nga data e njoftimit të vendimit të gjykatës
- 4.18. Tarifa gjyqësore e veçantë paguhet në kohën e paraqitjes së kërkesës në gjykatë.
- 4.19. Kur pala nuk paguan tarifata gjyqësore brenda afatit të caktuar (kërkesëpadi me të meta), kërkesëpadi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet palës së bashku me aktet e tjera. Në këtë mënyrë vepohet edhe kur të metat konstatohen gjatë gjykimit të çështjes.
- 4.20. Tarifa gjyqësore e paguar në gjykatën që ka shpallur mos kompetencën lëndore ose tokësore, është e vlefshme edhe për gjykatën kompetente sipas ligjit.
- 4.21. Pullë takse vendoset në çdo kopje të dokumentit të lëshuar, për të gjitha dokumentet që, sipas ligjit, duhet të pajisen me pulla. Dokumentet janë të vlefshme kur pulla është e vulosur nga Gjykata që kryen shërbimin. Lejohet përdorimi i një ose më shumë pullave për dokument të lëshuar, me kusht që ato të plotësojnë vlerën e tarifës.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR